



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:189412

Datë: 05.08.2024

Numri i dokumentit: 06020486

Ac.nr.251/23

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, gjyqtari individual Adnan Konushevci, në çështjen përmbarimore të kreditorit KRU “HIDRODRINI”, SH.A., me seli në Pejë, Rruga “Lekë Dukagjini”, Nr.16, ndaj debitorit A.B, nga Komuna në I..., Rruga “Smajl Kabashi”, Nr. 35, me bazë juridike përmbarimore - borxh, në vlerë prej 1,201.95 euro, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit PPP.nr.11/2020 datë 13.1002022, të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, me datë 05.08.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit A.B, nga Komuna në I..., Rruga “Smajl Kabashi”, Nr. 35, ndërsa aktvendimi PPP.nr.11/2020 datë 13.1002022, të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog, në pikën -II-, VËRTETOHET.

II. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktvendimit të atakuar, në pikën -I-, në pjesën është pranuar prapësimi i debitorit.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Istog, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.11/2020 datë 13.1002022, ka vendosur si në vijim: *“I. PRANOHET PJESËRISHT SI I BAZUAR, prapësimi i debitorit A.B nga Istogu rr. “Smajl Kabashi” nr. 35, i parashtruar kundër urdhrin të Përmbaruesit Zija Bala në Pejë P.nr. 729/19 të datës 24.12.2019, dhe atë për vlerën e borxhit në shumë prej 694,35 €. II. REFUZOHET SI I PABAZUAR, prapësimi për pjesën tjetër të detyrimit në të holla në shumën prej 507,06 € të cilin detyrim në të holla obligohet pala debitore që ta përmbush ndaj kreditorit “.*

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të aprovoj si të bazuar ankesën e kreditorit dhe të ndryshoj aktvendimin e atakuar, dhe të shfuqizon urdhrin përmbarimor të Përmbaruesit Zija Bala në Pejë P.nr. 729/19 të datës 24.12.2019.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm-ekstraktit të verifikuar nga librat e afariste për pagesën e shërbimeve lidhur me konsumimin e ujit, me numër të konsumatorit 2012044203 për periudhën kohore 01.01.2015 – 23.12.2019, lidhur me borxhin, në vlerë prej 1,201.95 euro, Përmbartuesi Privat Zija Bala në Pejë, e ka lejuar përmbartimin e kërkuar me urdhrin përmbartimor P.nr.729/19 të datës 24.12.2019, kundër këtij urdhri debitori ka ushtruar prapësim me datë 13.01.2020, ndërsa kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të shkresave të lëndës, prapësimin, ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Gjykata e Apelit e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Duke marr parasysh se në rastin konkret kemi të bëjmë me propozim për përmbartim, në bazë të dokumentit të besueshëm që me dispozitën e nenit 29, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcaktohet se: *“përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm dhe se dokument i besueshëm sipas LPP-së janë: ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Dokumenti i besueshëm, është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar, në rastin konkret kemi të bëjmë me dokument të besueshëm siç është ekstrakti i verifikuar nga libri afarist, me numër të konsumatorit 2012044203 për periudhën kohore 01.01.2015 – 23.12.2019. Ekstrakti është i përshtatshëm për përmbartim ngase është i dorëzuar në origjinal, në të është cekur kreditori dhe debitori, objekti dhe lloji andaj, nga kjo rezulton se dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm

për përmbardim dhe se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Lidhur me pretendimet ankimore të debitorit sa i përket parashkrimit konform nenit 360 të LMD-së, dhe pagesave të bëra nga ana e debitorit, Gjykata ankimore vlerëson se është pretendim i pabazuar pasi që në bazë të nenit 360, paragrafi 1, pika 1.1 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti: kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake”*, ndërsa paragrafi 2 i po këtij neni përcakton se *“afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga fundi i vitit, në të cilin arrihen kërkesat për pagesë”*. Ndërsa me nenin 368 të LMD-së parashihet se *“Par. 1. Parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Par. 2. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e kështit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit”*. Në rastin konkret shihet se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitën e lartcekur pasi që kur kemi të bëjmë me shërbimin e konusimit të ujit për nevoja shtëpiake duhet vlerësuar afati një vjeçar i parashkrimit, pasi që e drejta e realizimit të borxhit për shumën e faturuar për çdo muaj veç e veç parashkruhet në afatin prej 1 viti, nga momenti i dorëzimit të faturës dhe se në çdo faturë është paraparë afati i pagesës dhe nga i cili afat fillon të rrjedh parashkrimi.

Gjykata e Apelit, më rastin e vendosjes mori për bazë edhe pretendimin e debitorit, se dispozitivi i aktvendimit të goditur më ankesë i gjykatës së shkallës së parë, është në kundërshtim më vetën dhe shkresat tjera të lëndës. Mirëpo edhe ky pretendim i debitorit ka qenë pa ndikim në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, sepse është e qëndrueshme se gjykata e shkallës së parë, në pikën -I-, të dispozitivit e ka vendosur vetëm shumën për të cilën e ka shfuqizuar urdhrin në lartësi prej 694.35 euro, si shumë-kërkesë e parashkruar, pa e theksuar se për cilën periudhë kohore është vendosur për parashkrim. Poashtu edhe në pikën -II-, të dispozitivit të aktvendimit të goditur më ankesë është vendosur, shuma prej 507.06 euro, shumë kjo që debitori i detyrohet kreditorit për ta përmbushur, edhe në këtë rast nuk është përcaktuar periudha kohore, sa i përket këtij borxhi. Mirëpo kjo nuk e bënë ekzaminimin e aktvendimit të pa ekzekutueshëm sepse nga gjykata e shkallës së parë janë dhënë arsye të mjaftueshme për secilin vit, se kur ka filluar që kërkesa të bëhet e arritshme dhe kur është arritur parashkrimi i kërkesës. Ashtu që kërkesa e kreditorit që ka të bëjë në shumën prej 694.35 euro, për periudhën kohore 01.01.2015 e deri me datë 31.12.2017, është parashkruar, siç më të drejtë është vlerësuar edhe nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa kërkesa e kreditorit që ka të bëjë, në shumën prej 507.06 euro, për periudhën

kohore 31.01.2018 e deri më datë 30.11.2019, mbetet detyrim i borxhit, për ta paguar debitori ndaj kreditorit, në emër të konsumimit të ujit për nevoja shtëpiake.

Gjykata e Apelit, me rastin e vendosjes mori për bazë edhe pretendimet tjera të paraqitura më ankesë te debitorit, por të njëjtat kanë qenë pa ndikim për vendimmarrje ndryshe në këtë rast.

Gjykata e Apelit, vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktvendimi, për pjesën që është pranuar prapësimi, me aktvendimin e goditur më ankesë sepse ndaj kësaj pjesë të aktvendimit, nuk është paraqitur ndonjë ankesë, andaj pjesa kjo pjesë e aktvendimit të ankimuar ka mbetur e pa shqyrtuar.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.251/2023 me datë 05.08.2024

Gjyqtari
Adnan Konushevci